



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:199760

Datë: 11.12.2024

Numri i dokumentit: 06579596

C.nr.3062/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.T nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson Av. V.U nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e kualifikimit arsimor dhe kompensim mbi bazën e përvojës së punës, me vlerë të kontestit 3,019.26 euro, jashtë seance me datë 11.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia C.nr.3062/24 e datës 03.07.2024, e paditësit A.T nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, për pagesën mbi bazën e kualifikimit arsimor dhe kompensimin mbi bazën e përvojës së punës, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore shtesë në shumën prej 20 euro.

A r s y e t i m

Paditësi A.T nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson Av. V.U nga Vushtrria, pranë kësaj gjykate me datë 03.07.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, për pagesën mbi bazën e kualifikimit arsimor dhe kompensimin mbi bazën e përvojës së punës, në shumën totale prej 3,019.26 euro. Me datë 28.08.2024, paditësi kishte paguar taksën gjyqësore në shumën prej 20 euro.

Me nenin 12 pika 12.1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, përcaktohet se *për kërkesat nga 2,501.00 euro e deri në 5,000.00 euro, duhet të paguhet taksa në shumën prej 40.00 euro.*

Me aktvendimin e datës 20.11.2024, gjykata përmes përfaqësuesit të tij, e ka ftuar paditësin që në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore shtesë në shumën prej 20 euro, me paralajmërimin se nëse nuk paguhet taksa shtesë, padia do të konsiderohet e tërhequr.

Përfaqësuesi i paditësit me datë 27.11.2024, e ka pranuar Aktvendimin për pagesën e taksës shtesë, por edhe pas kalimit të afatit, nuk e ka bërë pagesën e taksës shtesë.

Gjykata, në këtë rast nuk gjeti se ekzistojnë konditat për lirimin e paditësit nga pagesa e taksës gjyqësore shtesë, andaj konform nenit 253 par.5 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.3062/24, me datë 11.12.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.